# Procesverbal

**Konsultim publik:** *Me Banorët e Njësisë Administrative Qytet, Qënder*

**Data :** 29/07/2026 **Ora :** 10:00 **Vendi:** Pallati Kulturës Tepelenë

**Numri i pjesëmarrësve :** Gjithësej 38 persona të pranishëm. (13 gra dhe 25 burra).

**1.Titulli i Projekt – aktit që konsultohet:** 1.Hartimi i dokumentit të parë per Programin Buxhetor Afatmesem (PBA) 2027-2029. 2.Plani i Menaximit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM)

**2. Pjesëmarrës :**

1. **Gramos Sako** **(Kryetar i Bashkisë)**
2. **Arben Gumeni** (Kryetar i Këshillit)
3. **Julinda Karteri** **(N/Kryetar)**
4. **Florenc Korça** **(Administrator i Njesise Administrative Qytet)**
5. **Leonidha Shumeli** **(Administrator i Njesise Administrative Qender)**
6. **Ela Skenderaj** **(Koordinatori informimit)**
7. **Gezim Shehu** (Drejtori Zhvillimi Rural)
8. **Adi Vela** (DSHP)
9. **Besnik Maca** (Anëtar Këshilli)

**Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni**, përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen në dëgjesën publike të organizuar për Hartimin e dokumentit të parë për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 dhe Planin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Ai theksoi se fokusi kryesor do të jetë te shërbimet bazë në komunitet, si pastrimi, ndriçimi publik, mirëmbajtja e varrezave, shtrimi i rrugëve, si dhe mbështetja për blegtorinë, duke ftuar pjesëmarrësit të paraqesin mendimet dhe nevojat e njësive të tyre për t'u përfshirë në buxhetin e vitit 2027.

Më pas, fjala iu dha **Kryetarit të Bashkisë, z. Gramos Sako**. Ju falenderoj për prezencen tuaj në këtë dëgjese publike.

Qëllimi i takimit është diskutimi i Projektbuxhetit të vitit 2027 dhe dëgjimi i problematikave të komunitetit. Bashkia ka fokusuar ndërhyrjet kryesisht në shërbimet bazë, si:

- Pastrami I territorit
- Menaxhimi I mbetjeve
- Mirembajtja e hapesirave publike
- Permiresimi I sherbimit ndaj komunitetit
- mirëmbajtja e varrezave publike;
- rikonstruksioni i lerave;
- rikonstruksioni i rrugëve të brendshme.
- Perballimin e emergjencave
- Rritjen e kapaciteteve te nderhyrjes
- Mbrojten e jetes dhe prones se qytetareve

Programi i investimeve kapitale 2027-2029 kane vleren 108,350 mije leke. Burimet e financimit jane :

- Transferta e pakushtezuar
- Te ardhurat e bashkise

Ne arsim :

- Rikonstruksion i shkolles "Avni Rustemi"
- Bashkefinancim per rikonstruksionin e shkolles "7-Marsi",

me qellim permiresimin e kushteve te mesimit dhe krijimit te ambjenteve me te sigurta per nxenesit. Per sa i perket infrastruktures rrugore :

- Rikonstruksion rrugesh ne qytet dhe blloqe banimi
- Rikonstruksion rrugesh rurale
- Sistemime dhe asfaltime ne zona te ndryshme

Sherbime Publike :

- Blerje mjetesh transporti
- Blerje konteineresh per menaxhimin e mbetjeve
- Permiresimi i kapaciteteve te sherbimeve publike

Bujqesi dhe burime natyrore :

- Rehabiliteti i diges se ujembledhesit Turan
- Permiresimi i kullotave
- Hartimi i planeve te menaxhimit te pyjeve dhe kullotave

Godina dhe projekte te reja:

- Rikonstruksioni i godines se Njesise Administrative Qender
- Hartimi i projekteve dhe preventivave per investime te ardhshme

Objektivat Kryesore te PBA 2027-2029, Bashkia Tepelene synon :

- Permiresimin e cilesise se sherbimeve publike
- Zhvillimin dhe mirembajtjen e infrastruktures
- Mbeshtetjen e arsimit dhe institucioneve publike
- Zhvillimin e zonave rurale dhe turizmit
- Forcimin e mbrojtjes civile
- Rritjen e transparences dhe eficiences ne perdorimin e fondeve publike

Konsultimi me qytetaret, kjo degjese publike eshte nje mundesi e rendesishme per qytetaret dhe grupet e interest per te paraqitur :

- Propozime per investime
- Kerkesa per permiresimin e sherbimeve
- Sugjerime per zhvillimin ekonomik dhe social te territorit

Sugjerimet dhe opinionet e paraqitura do te shqyrtohen gjate hartimit te Dokumentit Perfundimtar te rogramit Buxhetor Afatmesem 2027-2029. Faleminderit per pjesemmarjen dhe konstributin tuaj!

**Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me cështjen që konsultohet si vijon :**

- **Administratori i Njësisë Qendër Z. Leonidha Shumeli ;**

Hartimi i projektbuxhetit 2027–2029 është një moment i rëndësishëm jo vetëm për Njësinë Administrative Qendër, por për gjithë Bashkinë Tepelenë. Një nga shtyllat kryesore për garantimin e shërbimeve cilësore është parashikimi i saktë i të ardhurave, pasi çdo fshat ka planin e vet të të ardhurave, të cilat rikthehen në formën e shërbimeve dhe investimeve për komunitetin.

Njësia Administrative Qendër parashikon rreth 8.7 milion lekë, dhe vit pas viti janë realizuar rreth **101%** e të ardhurave. Aktualisht, shërbimet bazë si ndriçimi, pastrimi dhe mirëmbajtja e kanaleve ujitëse janë në nivele të kënaqshme. Investimet që mbeten prioritet për t'u adresuar përfshijnë:

- rehabilitimin e rrugëve të paasfaltuara,
- përmirësimin e rrjetit të ujësjellësit dhe qendrave të fshatrave,
- hapjen dhe pastrimin e lerave,
- zgjerimin e sistemit të ndriçimit në fshatra, i cili po kalon në një etapë të re me instalimin e paneleve diellore.

## Problematikat dhe objektivat sipas fshatrave

### Fshati Hormovë

- Pastrimi i përrojit të Gurrës.
- Shtrimi me beton i rreth 400 metrave në lagjen e poshtme.
- Përmirësime asfaltike të rrugës.
- Ndërhyrje për furnizimin me ujë të pijshëm në lagjen e sipërme dhe lagjen e poshtme.

### Fshati Lekël

- Shtrim me beton në lagjen e poshtme dhe lagjen Cikuri (rreth 200 m).
- Pastrim i lerave dhe krijimi i lerave të reja.
- Kanal vaditës Kodër – Fushë Lekël (1.5 km).

### Fshati Kodër

- Shtrim me beton (350 ml).
- Hapje dhe rehabilitim i kanalit vaditës.

### Fshati Peshtan

- Ndërhyrje në përrua për parandalimin e dëmtimeve.
- Rehabilitim i çezmës së fshatit.
- Shtrim rruge (300 ml).
- Ndërtim i ujësjellësit.

### Fshati Mezhgoran

- Asfaltim i rrugës.
- Shtrim dhe sistemim i rrugëve të brendshme.

### Fshati Dragot

- Ndërhyrje në qendrën e fshatit.
- Shtrim me beton drejt kalasë (200 m).
- Rehabilitim dhe pastrim i kanaleve kulluese.

### Fshati Beçisht

- Përmirësim i shtresës asfaltike të rrugës.
- Shtrim me beton (250 ml).
- Riparim i çezmës së fshatit.

### Fshati Luzat

- Shtrim i rrugëve të brendshme në gjithë fshatin (350 m).
- Ndërtim i qendrës së fshatit.
- Ndërtim i ujësjellësit të fshatit.

**Fshati Benç**

- Sistemim i rrugëve të brendshme (150 ml).
- Hapje rruge drejt parcelave bujqësore.

**Fshati Veliqot**

- Shtrim me beton në lagjen e poshtme dhe lagjen e sipërme (350 m).
- Mirëmbajtje e qendrës së fshatit.
- Sistemim i rrugës drejt parcelave bujqësore.

**Fshati Turan**

- Ndërhyrje në qendrën e fshatit.
- Shtrim rruge me beton (300 ml).
- Ndërtim i ujësjellësit.
- Rrethim i varrezave të fshatit.
- Ndërtim i një lere të re dhe pastrim i lerës ekzistuese.

**Fshati Dukaj**

- Shtrim i rrugëve në vazhdimësi.
- Pastrim i lerave.
- Ndërhyrje në rrugën Dukaj–Kordhaj.
- Asfaltim i rrugës Kordhaj–Memaliaj.
- Ndërhyrje në ujësjellësin e Kordhajit.
- Sistemim i përroit të Kordhajit.

**Fshati Salari**

- Ndërhyrje në qendrën e fshatit.
- Rrethim i varrezave.
- Shtrim i rrugëve të brendshme (500 m).
- Pastrim dhe mirëmbajtje e lerave.

**Fshati Mamaj**

- Shtrim me beton (200 ml).
- Sistemim i qendrës së fshatit.
- Ndërtim emergjent i ujësjellësit të fshatit.

## Objektiva të përgjithshme për të gjitha fshatrat

- Pikë-lidhje e energjisë elektrike, dhe ujit të pijshëm në të gjitha ambulancat.
- Mirëmbajtje dhe ndriçim në fshatra.
- Mbjellje pemësh në fshatrat Benç, Salari, Kodër, Hormovë.
- Pastrim dhe lyerje në shkolla.
- Mirëmbajtje e aseteve kulturore dhe infrastrukturore.

**Diskutime.**

**Muharrem Zia (Kryeplaku I fshatit Mamaj) :** Ne majkosh sistemi I tokave bujqesore, sistemimi I rrugeve me beton. 7km Mamaj-Turan. Ne Mamaj duhet bere Ujesjellesi. Depozite ne Mamaj, eshte 3km nga burimi, ka uje por nuk funksionon.

**Behar Islami:** Ujesjelles tek bregu I kripes. Nuk lidhin ujin. Linjat nga pompat ne Kordhaj deri ne shtepite e banoreve. Nuk ndizen pompat, ka depozite por ska uje.

**Dritan Memushi:** Autobuse per ne Uje te Ftohte tani gjate periudhes se veres , 2 ore paradite dhe 2 ore mbasdite.

**Xhevit Mana (Pergjegjes per Sektorin Zjarrefikes):** Kerkojme bashkepunimin tuaj dhe te qytetareve ne kete degjese publike per ndergjegjesim mbi zjarret, te na informoni ne kohe qe te behet nderhyrja ne kohe per stabilizimin e situatave. Mos te kemi raste emergjente.

**PLANI I MENAXHIMIT TE INTEGRUAR TE MBETJEVE**

**Adi Vela:** Menaxhimi i integruar i mbetjeve urbane përbën një nga shërbimet publike me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e mjedisit, përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare, ruajtjen e shëndetit publik dhe rritjen e cilësisë së jetesës së komunitetit.

Në këtë kuadër, Bashkia Tepelenë ka ndërmarrë procesin për hartimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për periudhën 2026–2031, i cili do të shërbejë si dokumenti kryesor strategjik dhe orientues për organizimin, administrimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë.

Hartimi i këtij plani synon të evidentojë gjendjen aktuale të shërbimit, problematikat dhe nevojat ekzistuese, të përcaktojë objektivat afatmesme dhe afatgjata, si dhe masat konkrete që duhet të ndërmerren për garantimin e një sistemi më funksional, të qëndrueshëm dhe në përputhje me standardet ligjore dhe mjedisore.

OBJEKTIVAT PËR PERIUDHËN 2026–2031

Plani Vendor i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve do të synojë përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë dhe eficiencës së shërbimit, rritjen graduale të mbulimit të territorit dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe të kontrollueshëm.

Objektivat kryesore për periudhën 2026–2031 do të përfshijnë:

- shtrirjen graduale të shërbimit në të gjithë territorin e Bashkisë Tepelenë;
- përmirësimin e frekuencës së grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve;
- shtimin, zëvendësimin dhe mirëmbajtjen periodike të kontejnerëve;
- përmirësimin e mjeteve dhe pajisjeve teknologjike në funksion të shërbimit;
- krijimin gradual të kushteve për ndarjen e mbetjeve në burim;
- nxitjen e ripërdorimit dhe riciklimit të materialeve të përshtatshme;
- reduktimin e depozitimeve të paligjshme dhe rehabilitimin e zonave të ndotura;
- rritjen e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit me komunitetin;
- forcimin e kontrollit, monitorimit dhe raportimit mbi realizimin e shërbimit.

Ju faleminderit!

**Mbajtëse të P/Verbalit**

**Klevisa Kume** **Efjenia Masho**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË**

**KËSHILLI BASHKIAK**

Listë Prezenca e personave të pranishëm në dëgjesën publike të zhvilluar në datën 30.07.2026 në Pallatin e Kulturës kati i dytë, ora 10:00. Njësia Administrative Qendër-Qytet Tepelenë.

Takim konsultuese: Hartimi i dokumentit të parë pë Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027-2029. Plani i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (PVMIM).

| Nr | Emër Atësi Mbiemër | Institucionon/organizata | Email/telefon | firme |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pëllumb Kasem Hoxha | Energjiçir. Bashk. Tep. | | |
| 2 | Xhuharrem Zia | Sherb. Publike | | |
| 3 | Altin Çota | | | |
| 4 | Mira Muça | MZSH | | |
| 5 | Xhevit Mano | MZSH | | |
| 6 | Enerik Lamaj | IVMT | | |
| 7 | Julian Nemushi | -"- | | |
| 8 | Avni Abedlari | Spec. | | |
| 9 | Eliduni Thola | [illegible] | | |
| 10 | Karallambo Beca | | | |
| 11 | Jonida Spaha | [illegible] | | |
| 12 | Lavdije Selima | | | |
| 13 | Nazo Meçaj | Nj. A. Qendër | | |
| 14 | Luljzime Merkohasani | Nj. A. Qendër | | |
| 15 | Kristjela Sulaj | Specialiste | | |
| 16 | Almarina Paza | Specialist | | |
| 17 | Blerina Kasneci | Specialiste | | |
| 18 | Besiana Xhafa | Specialist | | |
| 19 | [illegible] | [illegible] | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 20 | Tikli Hysa | | | |
| 21 | Dea Nazëraj | | | |
| 22 | Halime Gjudraj | | | |
| 23 | Asfrit Jacepi | | | |
| 24 | Rudian Hoxhaj | | | |
| 25 | Florenc Korça | | | |
| 26 | Gjitan [illegible] | | | |
| 27 | Gëzim Shehu | | | |
| 28 | Behar Islami | | | |
| 29 | Niko Leçaj | | | |
| 30 | GONI OSONCA | | | |
| 31 | Efjenia Masho | | | |
| 32 | Xhulia Meta | | | |
| 33 | Pedi Roma | | | |
| 34 | Besmir Maço | | | |
| 35 | Dushan Alia | | | |
| 36 | Maksim Shehu | | | |
| 37 | Lumturi Desnica | | | |
| 38 | Petrit [illegible] | | | |
| 38 | Selvijan Hyka | | | |
| 40 | | | | |
| 41 | | | | |
| 42 | | | | |
| 43 | | | | |
| 44 | | | | |
| 45 | | | | |
| 46 | | | | |
| 47 | | | | |
| 48 | | | | |
| 49 | | | | |
| 50 | | | | |
| 51 | | | | |
| 52 | | | | |

**FOTO NGA KONSULTIMI PUBLIK NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KURVELESH QENDËR – QYTET**















